

URDHËR
Nr. 129, datë 1.8.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E MOSHËS PËR KATEGORITË E PRANIMIT NË ROLET
POLICORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 69, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me qëllim përcaktimin e kufirit të moshës për pranimin në rolet policore të Policisë së Shtetit,

URDHËROJ:

1. Mosha për kategorinë e pranimin në rolin zbatues, sipas shkronjës “a/i”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, është deri në 30 vjeç.
 2. Mosha për kategorinë e pranimin në rolin e parë drejtues, sipas shkronjës “b/ii”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, është deri në 30 vjeç.
 3. Mosha për kategorinë e pranimin në rolin e parë drejtues, sipas shkronjës “b/v”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, është deri në 35 vjeç.
 4. Për kategoritë e pranimin, të përcaktuara në shkronjën “a/ii” dhe shkronjën “b/i”, “b/iii” dhe “b/iv”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 82/2024, nuk aplikohet kufizim moshe.
 5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha